REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 01
Nr.Prot / Broj Prot / Prot.No: 05-4332
Nr.i faqeve / Br.stranica: -01-
Data / Datum / Date: 29 07 14
Prishtinë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health*
Zyra e Ministrit/ Ured Ministra/ Office of the Minister

**Nr. 54 /14**
**Datë: 29.07.2014**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë,
Në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
Duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010);
Duke u bazuar në Nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 9 paragrafi ii të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011);
nxjerr:

## VENDIM

**I.** Qarkulluesit e licencuar me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale ju vazhdohet afati edhe për tre (3) muaj për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr.13/2013.

**II.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Me qëllim të krijimit të politikave shëndetësore, ndryshimeve substanciale në procedurat e licencimit dhe importimit të produkteve dhe pajisjeve medicinale të parapara me ndryshimet legjislative që është në procedurën përfundimtare projektligji për produkte dhe pajisje medicinale në Kuvendin e Kosovës, rekomandimin e fuqishëm nga inspektorët e BE nga Polonia si pjesë e projektit TAIEX në AKPM që procedurat e importimit të ndryshohen dhe që importuesit të ndahen nga qarkulluesit me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Prof. Dr. Ferid Agani**

**Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë**

I dërgohet:
- Zëvendësministrave në MSh
- Dr. Gani Shabani, Sekretar i Përgjithshëm MSh
- U.D. Kryeshefit Ekzekutiv AKPM
- Arkivit MSh